

VENDIM
Nr. 211, datë 9.9.2025

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 160, DATË 18.7.2025, “MBI PEZULLIMIN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË ‘IDI 2005’ SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 14, pika 10, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1849/11 prot., datë 3.9.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 160, datë 18.7.2025, “Mbi pezullimin e vendimarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me kërkesën e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 160, datë 18.7.2025, vendosi të pranojë kërkesën e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 8.8 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, deri në një njoftim të dytë nga vetë shoqëria, duke i lënë detyrë asaj që brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve të depozitojë në ERE kontratën e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës me nr. 1849/8 prot., datë 23.7.2025, dhe me *email*-in e datës 25.8.2025, i është kujtuar detyrimi i sipërcituar.

- Me *email*-in e protokolluar në ERE me nr. 1849/10 prot., datë 29.8.2025 shoqëria ka njoftuar vështirësinë për nënshkrimin e kontratës dhe ka kërkuar pezullimin e procedurës së licencimit për një afat të pacaktuar, duke u angazhuar të depozitojë kontratën sapo ta nënshkruajë.

Pezullimi i afatit të vendimarrjes

- Referuar nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, kur shqyrtimi i një çështjeje administrative varet nga një çështje tjetër ligjore e pavarur (“çështje paraprake”), për të cilën është kompetente një gjykatë ose organ tjetër, organi administrativ ka të drejtë të pezullojë procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë dhe njofton palët për pezullimin.

- Gjithashtu, në nenin 14, pika 10, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë, rast pas rasti, pezullimin e vendimarrjes pas fillimit të procedurës.

- Ndërsa në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet se një akt administrativ mund të anulohet shfuqizohet apo ndryshohet kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin.

- Për sa më sipër, referuar kërkesës së shoqërisë dhe parashikimeve të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, duke qenë se kontrata e nënshkruar me MIE-n është dokument thelbësor për këtë procedurë, vlerësohet të pranohet kërkesa e saj dhe të pezullohet vendimarrja e Bordit të ERE-s për licencimin, deri në depozitim të kontratës së nënshkruar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 160, datë 18.7.2025, ndryshon dhe bëhet:

“2. Ky vendim është objekt rishikimi me depozitimin nga ana e shoqërisë të kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja, që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti